



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË ARSIMIT DHE ÇERDHES

Nr. _____ Prot.

Korçë, në datë 06.09.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Pajisje elektronike për laboratorët kompjuterikë në shkollat e Qytetit

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (C.P.V.): Kompjuterë personale-30213000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.853.166 (dy milion e tetëqind e pesëdhjet e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjet e gjashtë) lek pa tvsh,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Gjykata Kushtetuese ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.P.P., nenit 26, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit të kualifikimit të percaktuara në D.S.T.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të L.P.P., nenit 40, pika 5, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore/Vërtetim të gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare, nga data e zhvillimit të procedurës në vlerën prej jo më pak se 40% të fondit limit i vënë në dispozicion. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një Vit të periudhës së kërkuar. Si provë për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e L.P.P., si dhe nenin 43, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

(Eshte minimumi i kerkeses per arsye qe te vertetoje qe ka kapacitet financiar per ta kryer kete furnizim dhe sherbimet te lidhura me ato). Rekomandimi i nr. 1797/1 i dates 10.03.2022

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

(Eshte minimumi i kerkeses per arsye qe te vertetoje qe ka kapacitet financiar per ta kryer kete furnizim dhe sherbimet te lidhura me ato). Rekomandimi i nr. 1797/1 i dates 10.03.2022

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente per menaxhimin e cilësisë.

(Çertifikata e mesiperme duhet te jenë të leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akredituese te njohura nga Republika e Shqiperise, te noterizuara).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (D.P.A.).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën. Përbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 3 (tre) punonjës të siguruar, ku përfshihet të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në nivel teknik.

Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklaratë për stafin përgjegjës.
- Certifikata përkatëse/ Transkriptet përkatëse.
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig. 025/a për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesat e mësipërme duhet të vërtetohen me: Certifikatat /Transkriptet përkatëse.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b) dhe c), të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

-Për kriterin në pikën a), duke qenë se objekt i procedurës së prokurimit është furnizimi dhe vendosja e pajisjeve kompjuterike (Kompjuter, Laptop, UPS, Printer Label, Printer me WiFi dhe Monitor 31.5, është gjykuar e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist të çertifikuar në nivel teknik për Printerin Label që do të ofertojë duke

qenë që është produkt specifik dhe lind nevoja për të siguruar instalim të saktë dhe suport gjatë kohëzgjatjes së garancisë.

-Per arsye se gjate periudhes se garancise operatori ekonomik pjesmarres duhet te kryej sherbime ne lidhje me pajisjet e prokuruar. Gjithashtu nga eksperienca e viteve te kaluara ka lindur nevoja e personelit te kualifikuar per cdo pajisje per realizimin ne kohe te riparimeve dhe sherbimeve te lidhura me to ne kohe shume te shpejt per mbarvajtjen e punes se punonjesve te Gjykates Kushtetuese, duke qene se sa e rendesishme eshte sistemi i informarizimit ne kete institucion sidomos ne kohe reale te realizimeve te seancave gjyqesore te Gjykates Kushtetuese.

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Oferte teknike e cila duhet te pasqyroje marken dhe modelin e produktit te ofruar dhe specifikimet teknike sipas kerkesave te D.S.T.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose broshura teknike për mallin që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofertuar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu te permbaje karakteristikat teknike te cdo artikulli që është objekt i prokurimit me qellim që autoriteti kontraktor te gjykoje nese malli i ofertuar ploteson kerkesat teknike te percaktuara ne DST. Specifikimet teknike te markes dhe modelit te ofertuar do te krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST per perputhshmerine e tyre).

Argumentimi: Në bazë të pikës 5, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet te vertetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit, si dhe kur te realizohet furnisimi me pajisje, ato te jene te shoqeruar me certifikata perkatase e origjines.

Gjithashtu duhet te paraqesin oferte teknike e cila duhet te pasqyroje marken dhe modelin e produktit te ofruar dhe specifikimet teknike, te shoqeruara me kataloge ose broshura teknike për mallin që oferton per arsye qe te behet vlersimi ne baze te pajisjeve te ofertuara dhe me cfare tipi pajisjesh do te furnizohet institucioni.

2.4.3 Pajisjet te jene te shoqeruara nga certifikata perkatase e origjines.

2.4.4 Operatori Ekonomik fitues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi, ose Autorizim Distributori për mallrat objekt të kësaj kontrate. Në rast të paraqitjes së Autorizimit të Distributorit duhet të shoqërohet me lidhjen ndërmjet distributorit dhe prodhuesit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 5, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 si dhe 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet te vertetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit, si dhe kur te realizohet furnisimi me pajisje, ato te jene te shoqeruar me certifikata perkatase e origjines.

Ky kriter është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës "Blerje paisje kompjuterike" si dhe në përputhje me dispozitën e sipërcituar. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet këtij kriteri kërkon të garantohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në lidhje me origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht kërkon nga ofertuesit që të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar prej tij.

Dokumenti i kërkuar mund të sigurohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me mallrat objekt prokurimi dhe që kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre. Me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor sigurohet që mallrat objekt prokurimi të jenë sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisjet elektronike duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 40, pika 2, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike për paisjet Kompjuter Desktop 2, UPS 1000VA dhe Laptop Basic janë vendosur parametra teknike sipas standarteve të përcaktuara nga A.K.SH.I. Përsa i përket pajisjeve të tjera janë hartuar sipas kërkesave të institucionit për këto pajisje.

Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala "ose ekuivalent" e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

NJËSIA E PROKURIMIT

Vasjan Tona

Sonjela Zguri

Olgerta Demiras